



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Kuvendi i komunës së Rahovecit – Skupština opštine Orahovac



Në bazë të dispozitave të nenit 12. paragrafi 12.2 pika d) dhe nenit 14, paragrafi 1, të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr. 03/L-040, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës” nr. 28/ 15 qershor 2008, nenit 36. dhe 115. të Ligjit për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore, nr. 03/L-154, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 175/ 25 qershor 2009. nenit 13 dhe 84 të Ligjit për procedurën administrative nr. 02/L-28, nenit 5 të Statutit të komunës së Rahovecit, 01 nr. 569/1 të dt. 16. 12. 2010 dhe Propozimit të Kryetarit të komunës 01 nr. 99/2015, Kuvendi i komunës së Rahovecit, në mbledhjen e vet të mbajtur më 28 shtator 2015, merr

V E N D I M

Mbi shpalljen e Zonës së veçantë të interesit publik për ndërtimin e Tregut të gjelbër dhe prodhimeve qumështore në Rahovec dhe bartjen e pronës së paluajtshme

I.- Miratohet Propozimi i Kryetarit të komunës 01 nr. 99/2015 të dt. 25. 09. 2015, për shpalljen e Zonës së veçantë të interesit publik dhe bartet e drejta e pronës së paluajtshme nga PSH e Kosovës, KK Rahovec, shfrytëzuese – Drejtoria për kulturë, në emër të KK Rahovecit, shfrytëzuese - Drejtoria për ekonomi, zhvillim dhe turizëm, ngastrat kadastrale nr. 1313-1, në sipërfaqe prej 910 m²; 1313-2 në sipërfaqe prej 200 m²; 1313-4 në sipërfaqe prej 71 m²; 1313-5, në sipërfaqe prej 271 m² dhe 1314-0 në sipërfaqe prej 470 m², të gjitha sipas kulturës kopsht e kl. 2, tani tokë urbane të përfshira në Rajonin e ngushtë ndërtimor, si dhe ngastra nr. 1313-6, sipas kulturës arë e kl. 2, tani tokë urbane e përfshirë në Rajonin e ngushtë ndërtimor në sipërfaqe prej 271 m² z.k. Rahovec, prej PSH të Kosovës, KK Rahovec, në emër të Kuvendit të komunës së Rahovecit, shfrytëzuese - Drejtoria për ekonomi, zhvillim dhe turizëm.

II.- Ngastrat kadastrale të cekura nën I të këtij Vendimi, dedikohen për ndërtimin e Tregut të gjelbër të kombinuar ditorë dhe prodhimeve qumështore - bulmetit dhe nuk mund të shfrytëzohen për qëllime tjera.

III.- Kuvendi i komunës së Rahovecit - Drejtoria për ekonomi, zhvillim dhe turizëm, si Njësi themelore e vetëqeverisjes lokale, fiton të drejtën e shfrytëzimit të ngastrave të përmendura nën I. të këtij Vendimi, me regjistrimin e tyre në Regjistrin e të drejtave të pronës së paluajtshme, pranë Zyrës kadastrale komunale në Rahovec.

IV.- Ky Vendim nga ana e Kuvendit të komunës është nxjerr në bazë të autorizimit që disponon me pasurinë shtetërore, e cila sipas dispozitave të nenit 16. al. 2, të Ligjit mbi konfliktet administrative 03/L-202, nuk paraqet akt administrativ, sepse nuk është vendosur sipas autorizimit publik, por është vendosur sipas Propozimit të Kryetarit të komunës dhe autorizimit që komuna disponon me pronësinë shtetërore. Prandaj, pasi që ky Vendim nuk paraqet akt administrativ, por akt disponimi, kundër aktit të tillë nuk lejohet të zhvillohet konflikti administrativ.

V.- Bartja e të drejtës së shfrytëzimit të pronës së paluajtshme të cekur në nenin I. të këtij Vendimi, obligon Drejtorinë për ekonomi, zhvillim dhe turizëm, që brenda afatit prej 4 (katër) viteve, të fillojë ndërtimin e tregut të gjelbër të kombinuar ditor dhe prodhimeve qumështore – bulmetit, në të kundërtën humbë të drejtën e shfrytëzimit të ngastrave kadastrale të cekura nën I. të këtij Vendimi.

VI.- Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Kryetari i komunës dhe Drejtoria për ekonomi, zhvillim dhe turizëm e KK Rahovecit.

VII.- Ky Vendim hyn në fuqi 8 ditë nga dita e aprovimit dhe do të publikohet në Web faqen e komunës.

KUVENDI KOMUNAL RAHOVEC

01 nr. 100/2015

Rahovec, më 28. 09 .2015

Vendimi iu dërgohet:

Kryetarit të komunës;
Ministrit të Administrimit të Pushtetit Lokal;
Drejtorisë për ekonomi, zhvillim dhe turizëm dhe
Arkivit të komunës.

Kryesuesi i Kuvendit
Nahit Elshani



 **REPUBLIKA E KOSOVËS**
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu
-III- Nr. I prot. 100/2015 Më 28.09 20 15
Br. prot. 100/2015 Dt. 28.09 20 15
RAHOVEC - ORAHOVAC



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
MINISTRIA E MIEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSNOR /MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA/MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFICAT / CERTIFICATE

Numri i lëndës / Broj Predmet/Case Reference Number: Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission: Komuna / Opština / Municipality: Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:		Certificate-15-1170 28.09.2015- 9:30 Rahovec/Orahovac/Rahovec RAHOVEC/ORAHOVAC/RAHOVEC Rahovec/Orahovac/Rahovec	
---	--	---	--

Drejtori/Direktor/Director

A. TENDINAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësisë kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. unit No.	Lloji i njësisë Vista jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R U/R	Supërfaqja Površina Area m2	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradeno na dan Created on	Azhurnuar Ažurirano Updated
P-71510057-01313-6	PARCEL/E/ PARCEL/A/ PARCEL	Pronë shoqërore/Društvena Imovina/Socially owned Land	R	271	207-2000	29.05.2013	

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKJE JEDINICE /CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i kualifur Zyrano mesto Place name	Kodi postel Poštanski fab Postal Code	Hollësitë e adresës Pojednostni adrese Address Details	Krijuar më datën Uradeno na dan Created on	Azhurnuar Ažurirano Updated
UL. BRATISTVA JEDINS. -UL. BRATISTVA JEDINS. -/UL. BRATISTVA JEDINS.-	- //		29.05.2013	

A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORIÇENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriçenja parcelë Parcel type of use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriçenje parcelë Parcel current use	Klasa e kualitetit Klasa kualiteta Quality Class	Sipërfaqja Površina Area (m2)
1	Bujqësore/Poljoprivredno/Agriculture	Arat/Njive/Arable	Arë E Klasës 2/Njiva 2 Klasë/2nd Class Arable Land	271

B. PRONAR/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Lidhje broj ID. no.	Vendbanimi Prebivalište Residence	Kodi postar Poštanski lah Postal Code	Hollësitë e adresës Pojednostni adrese Address Details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Përshkrimi Opis Description	Azhuruar Ažurirano Updated
Poseidim Individual/Individualna Drzavina/single possessor	P.SHE KOSOV K.K RAHO VEC	KCID1502327	RAHOVEC/ORAHOVA C/ RAHOVEC	-	//	1/1	207-2000	



Republika e Kosovës
Republica Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E MEDIT DHE PLANIFIKIMIT HARËSHOR /MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA/MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFICAT / CERTIFICATE

PERSONI / OSOBA /PERSON : P.SHE KOSOV,K.K.RAHOVEC SHFRY.DREJ.PËR KULTUR

Numri i lendes/Broj Predmet/Case Reference Number Nu
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vrene izdavanja / Date and time of submission:
Komuna / Opština / Municipality:
Zyra Kadastrale Komune / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:

01 nr.99/2015
28.09.2015-9:25

Rahovec/Orahovac/Rahovec
Rahovec/Orahovac/Rahovec

Referenti/Referent/Referent

Drejtori/Direktor/Director

A. TË DHËNAT PËR PERSONIN / PODACI O OSOBI / PERSON'S DATA

Mbiemri/Emri i afarizmit (biznesit) Prezime/ Naziv poslovanja (biznisa) Last Name / Business Name	Emri Ime First Name	Emri i babait Ime oca Father's Name	Gjinë/ Pol Gender	Identifikuesi i personit/ biznesit Licni broj/ Broj poslovanja ID. No.	Shteti i shtetësisë apo regjistrimit Država državljanstva ili uknjiženja Country of citizenship	Ditëlindja/Data e themelimit/ Rodendan/Dan osnivanja/Date of Birth/Establishment	Azhurnuar Ažurirano Updated
P.SHE KOSOV,K.K.RAHOVEC SHFRY.DREJ.PËR KULTUR				E Panjohur/ Nepoznato/ Unknown	KCID1505142	Kosova/ Kosova/ Kosovo	

A.1 ADRESA E PERSONIT / ADRESA OSOBE / PERSON'S ADDRESS

Vendbanimi Prebivalište Residence	Kodi postat Poštanski fah Postal Code	Hollësitë e adresës Pojednosti adrese Address Details	Adresa tjetër Druga adresa Other address	Azhurnuar Ažurirano Updated
Rahovec/ Orahovac/ Rahovec	-	//	Rahovec	

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

Persona / Osoba /Person: P.SHE KOSOV,K.K.RAHOVEC


B. NJESIA KADASTRALE/ KATASTARSKA JEDINICA/CADASTRAL UNIT

Njësia kadastrale Katastarska jedinica Cadastral unit	Zona kadastrale Katastarska zona Cadastral zone	Lloji i njësise Vrsta jedinice Unit type	Tipi i pronës Tip imovine Property Type	Zona U/R Zona I/R	Kat/Kate Br./Sprat a/ Spratova	Vendi i qajfur Zvano mesto Place name	Sipërfaqja a Površina Area	Shtyryezimi aktual/Kultura-klasa Aktuelna upotreba/ Kultura-klasa Actual use/Culture-class	Pjesa e pronës Deo imovine	Lloji i së drejtës/ Vrsta prava/ Type of the right	Azhurua r Ažuriran o
P-71510057-01313-1	Rahovec/ Orahovac/ Rahovec	Parcelë/ Parcela/ Parcel	Pronë shoqërore/ Društvena Imovina/ Socially owned Land	U		Qytet/ Qytet/ Qytet	910 2// Klasë/ Agriculture-2nd Class Garden/	Bujqësore-Kopshë I Klasës Poljoprivredno-Basta 2 Klasë/ Agriculture-2nd Class Garden/	1/1	Posedim/Drz avina/Posse ssion	
P-71510057-01313-2	Rahovec/ Orahovac/ Rahovec	Parcelë/ Parcela/ Parcel	Pronë shoqërore/ Društvena Imovina/ Socially owned Land	U		Qytet/ Qytet/ Qytet	200 2// Klasë/ Agriculture-2nd Class Garden/	Bujqësore-Kopshë I Klasës Poljoprivredno-Basta 2 Klasë/ Agriculture-2nd Class Garden/	1/1	Posedim/Drz avina/Posse ssion	
P-71510057-01313-4	Rahovec/ Orahovac/ Rahovec	Parcelë/ Parcela/ Parcel	Pronë shoqërore/ Društvena Imovina/ Socially owned Land	U		Qytet/ Qytet/ Qytet	71 2// Klasë/ Agriculture-2nd Class Garden/	Bujqësore-Kopshë I Klasës Poljoprivredno-Basta 2 Klasë/ Agriculture-2nd Class Garden/	1/1	Posedim/Drz avina/Posse ssion	
P-71510057-01313-5	Rahovec/ Orahovac/ Rahovec	Parcelë/ Parcela/ Parcel	Pronë shoqërore/ Društvena Imovina/ Socially owned Land	U		Qytet/ Qytet/ Qytet	271 2// Klasë/ Agriculture-2nd Class Garden/	Bujqësore-Kopshë I Klasës Poljoprivredno-Basta 2 Klasë/ Agriculture-2nd Class Garden/	1/1	Posedim/Drz avina/Posse ssion	
P-71510057-01314-0	Rahovec/ Orahovac/ Rahovec	Parcelë/ Parcela/ Parcel	Pronë shoqërore/ Društvena Imovina/ Socially owned Land	U		Qytet/ Qytet/ Qytet	470 2// Klasë/ Agriculture-2nd Class Garden/	Bujqësore-Kopshë I Klasës Poljoprivredno-Basta 2 Klasë/ Agriculture-2nd Class Garden/	1/1	Posedim/Drz avina/Posse ssion	

Z.k Rahovec

kopja e planit

tregu i gjelbert



1/500

1315-1

Kuvendi i komunës së Rahovecit, në seancën e përbashkët të Dhomës së Punës së Bashkuar dhe Dhomës së Bashkësive Lokale, të mbajtur më 24.06.1985, duke shqyrtuar sipas kërkesës së BVI-së për kulturë në Rahovec me qëllim të ndërtimit të Shtëpisë së kulturës në Rahovec, në bazë të nenit 230. të Statutit të komunës së Rahovecit, ("Gz. zyrtare e KSAK", nr. 21/76 dhe 31/81), mori

A K T V E N D I M

I. VËRTETOHET SE është nga interesi i përgjithshëm shoqëror ndërtimi i Shtëpisë së kulturës në Rahovec, në parcelat si vijon:

- në pasurinë shoqërore parcela nr. 1318, me kulturë shtëpi dhe oborr, në rr. "M. Popoviq" në sipërfaqe prej 0.54,96 ha, nga lista poseduese nr. 984 KK Rahovec, shfrytëzues OPBI "Rahoveci" në Rahovec;
- në pasurinë private në parcelën nr. 1313/1, me kulturë kopsht kl. 2 në rr. "V. Bashkim" në Rahovec, në sipërfaqe prej 0.09,10 ha, nga lista poseduese nr. 50 KK Rahovec, pronë e Danica P. Leviq, e lind. Dimitrijeviq (e veja e Trifunit), nga Rahoveci, në parcelën nr. 1313/2, 1313/4, 1313/5 dhe 1313/6, me kulturë kopsht kl. 2. në sipërfaqe të përgjithshme prej 0.08,13 ha, në rr. "V. Bashkim" në Rahovec, nga lista poseduese nr. 2559 KK Rahovec, në emër të bashkëpronarit me nga 1/4, Xhemajli Fejzullah Dula, Jonuz F. Dula, Qamil F. Dula dhe Mesud Sedullah Shehu, të gjithë nga Rahoveci, në parcelën nr. 1313/3, me kulturë kopsht kl. 2 në rr. "V. Bashkim" në Rahovec, në sipërfaqe prej 0.08,28 ha, nga lista poseduese nr. 996 KK Rahovec në emër të bashkëpronarit me nga 1/3, Hisnije Sefer Dula (e veja e Bahtjarit), Hajrullah Bahtjar Dula dhe Tasim Bahtjar Dula, të gjithë nga Rahoveci, në parcelën nr. 1314, me kulturë kopsht kl. 2 në rr. "V. Bashkim" në Rahovec, në sipërfaqe prej 0.04,70 ha, nga lista poseduese nr. 953 KK Rahovec, në emër të bashkëpronarit me nga 1/4, Mexhit Halit Kadiri, Sulejman H. Kadiri, Vehap H. Kadiri dhe Hysen H. Kadiri të gjithë nga Rahoveci.

II. Për ekzekutimin e aktvendimit të përmendur do të kujdeset Drejtoria për punët pronësore-juridike e KK së Rahovecit.

A r s y e t i m

Bashkësia vetëqeverisëse e interesit për kulturë në Rahovec, me kërkesën e vet nr. 463-1, prej 17.06.1985, ka propozuar që Kuvendi i Komunës së Rahovecit, të bijë aktvendimin mbi vërtetimin e interesit të përgjithshëm shoqëror në parcelën kadastrale nr. 1318, pronë gjegjësisht shfrytëzues OPBI "Rahoveci" në Rahovec dhe në parcelat e pronarëve privat si që është shënuar me afër në dispozitiv të këtij aktvendimit.

Në arsyetimin e propozimit të vet gjegjësisht kërkesës BVI-ja për kulturë thekson se ka për qëllim gjegjësisht propozon ekspropriimin me qëllim të ndërtimit të Shtëpisë së kulturës në Rahovec.

Nga shkaqet e përmendura e duke patur parasysh nenin 2. të Ligjit mbi ekspropriimin ("Gz. zyrtare e KSAK", nr. 21/76 dhe 31/81), KK së Rahovecit në seancën e përbashkët të DHPB dhe DHBL, ka vërtetuar se ekziston interesi i përgjithshëm shoqëror dhe se në parcelat kadastrale të shënuara në dispozitiv të këtij aktvendimit në emër të pronarëve privat mund të fillohet me ekspropriimin.

Vendosur pranë KUVENDIT TË KOMUNËS SË RAHOVECIT, me 24.06.1985, 01 nr. 463-1.


Kryetari i DHPB
Trajko Miliçeviq, d.v.

Kryetari i Kuvendit
Rejhan Jaha, d.v.

Kryetari i DHBL
Misin Palushi, d.v.

Që përshkrimi është identik dhe origjinal vërteton:

Musa Jaha, Drejtoria
jurist i dipl.



Uprava za imovinsko-pravne poslove Skupštine opštine Orahovac, rešavajući po predlogu, odnosno zahtevu SIZ za kulturu u Orahovcu, br. 73 od 11.10.1985, na osnovu člana 14. i 15. Zakona o eksproprijaciji, („Službeni list SAPK“, Br. 21/78) i člana 202. ZUP-a, donosi:

R E Š E N J E

I USVAJA SE zahtev i EKSPROPRIJIŠE SE u korist SIZ-a za kulturu u Orahovcu, i prenosi se na društvenu svojinu u korist pomenutog SIZ-a katastarska parcela Br. 1313/1, koja se vodi u posedovnom listu Br. 50 S.O. Orahovac, u površini od 0.09,10 ha, na zvanom mestu „Put Bratstvo i Jedinstvo“ po kulturi vrt 2. klase, vlasništvo Lević Ud. Trifuna Danice, rođj. Dimitrijević iz Orahovca, za potrebe izgradnje DOMA KULTURE u Orahovcu.

II Opšti interes je utvrdjen na osnovu rešenja Skupštine Opštine Orahovac, Ol Br. 463-1 od 24.06.1985.

III Korisnik eksproprijacije, stiče pravo poseda na eksproprijisanu nepokretnost dana kad ovo rešenje postane pravosnažno, dok stvar naknade rešice se u posebnom postupku, u smislu člana 28. i 29. Zakona o eksproprijaciji.

IV Troškove postupka eksproprijacije u vezi sa donošenjem rešenja o eksproprijaciji snosi korisnik eksproprijacije.

O b r a z l o ž e n j e

SIZ za kulturu u Orahovcu, svojim zahtevom Br. 73 od 11.10.1985 godine, predložio je ovom Organu da preuzme sve potrebne radove i eksproprijše nepokretnosti parcele Br. 1313/1, kao što je naznačeno u dispozitivu ovog rešenja, za potrebe izgradnje „Doma kulture“ u Orahovcu.

Predlagac osim rešenja o opštem interesu zajedno sa predlogom o eksproprijaciji nepokretnosti dostavio je ovu dokumentaciju potrebnu koja je predviđjena članom 13. i 14. Zakona o eksproprijaciji, od koga se vidi da su ispunjeni svi uslovi postupka eksproprijacije.

Ovaj Organ, dana 27.12.1985 godine Lević Danicu iz Orahovca, saslušao je i naveo u zapisniku, koja je izjavila da nije protiv eksproprijacije, već da, s obzirom da je majka troje dece će da kao naknada za eksproprijisanu parcelu ne im se da naknada u novcu, već da joj se da neka druga parcela koja bi odgovarala za izgradnju stambene zgrade, kako bi obezbedila plate za ostala dva sina. Imenovana po drugi put insistira da je saglasna za eksproprijaciju pomenute parcele, ali nikako ne prihvata naknadu u novcu, već uz zanemu za neku drugu parcelu.

Ova Uprava, razmotrila je pismenost sa svim spisima, izjavu pomenute, te na osnovu člana 15. Zakona o eksproprijaciji nepokretnosti („S.L. SAPK“, Br. 21/78) usvojio je predlog pomenutog SIZ-a.

Odlučeno je kao u dispozitivu ovog rešenja.

Rešeno je pri UPRAVI ZA IMOVINSKO-PRAVNE POSLOVE SKUPŠTINE OPŠTINE ORAHOVAC, Br. 170/85 od 13.01.1986.

Drejtoria për punët pasurore-juridike e Kuvendit të komunës së Rahovecit, duke vendosur sipas kërkesës së BVI-së për kulturë në Rahovec, në bazë të nenit 14. dhe 15. të Ligjit mbi eksproprihimin, ("Gazeta zyrtare e KSAK", nr. 21/78) dhe të nenit 202 të LPPA bie

A K T V E N D I M

I APROVOHET propozimi për eksproprihim me kompensim, në favor të BVI-së për kulturë të Rahovecit, dhe bartet në pronësinë shoqërore, në llogari të BVI-së së përmendur, parcela kadastrale nr. 1313/2, e evidentuar në fletën poseduese nr. 2559 KK Rahovec, në sipërfaqe prej 0.02,00 ha, në vend të quajtur Rruga "V. Bashkim, Nën Shtet", me kulturë kopsht i klasës së 2. në emër të Mesud Sejfullah Shehut nga Rahoveci, për nevojat e ndërtimit të "Shtëpisë së kulturës" në Rahovec.

II Interesi i përgjithshëm është vërtetuar në bazë të aktvendimit të Kuvendit të komunës së Rahovecit, 01 nr. 463-1 prej 24.06.1985.

III Shfrytëzuesi i eksproprihimit, përfiton të drejtën e posedimit në paluajtshmërinë e ekspropriuar në ditën kur ky aktvendim merr formën e prerë, ndërsa kompensimi do të rregullohet në procedurën e veçantë, në vështirim të nenit 28. dhe 29. të Ligjit mbi eksproprihim.

IV Shepnzimet e procedurës në emër të eksproprihimit i paguan shfrytëzuesi i eksproprihimit.

A r s y e t i m

BVI-a për kulturë në Rahovec, me kërkesën e vet të paraqitur nr. 73 prej 11.10.1985, nga ky Organ kërkon që të kryhet eksproprihimi i paluajtshmërisë së parcelës së shënuar në dispozitivin e këtij aktvendimi, për nevojat e ndërtimit të "Shtëpisë së Kulturës" në Rahovec.

Propozuesi, përveç aktvendimit mbi interesin e përgjithshëm, propozimit ia ka bashkangjitur të gjitha provat e parapara në nenin 13. dhe 14. të Ligjit mbi eksproprihim, prej së cilës shifet se janë plotësuar të gjitha kushtet për kryerjen e procedurës së eksproprihimit.

Ky Organ, më 26.12.1985 të përmendurin e ka marrë në pyetje ku i njëjti ka deklaruar se nuk është kundër eksproprihimit, por se në emër të kompensimit si kundërvlerë të parcelës së tij kërkon që t'i ipet me ndërrim ndënjë parcelë tjetër adekuatë për ndërtimin e një dyqani dhe sipër shtëpi, pasi që me profesion është zejtar, me të cilat të ardhurat e mbanë familjen. Në fund i përmenduri thekson se nuk është kundër dhe është i pëlqimit që të eksproprihohet parcela e tij, por, me ndërrim, e jo me kompensim në të holla.

Kjo Drejtori, shqyrtoj lëndën me të gjitha shkresat, deklaraten e të përmendurit dhe duke u bazuar në nenin 15. të Ligjit mbi eksproprihimin e paluajtshmërisë ("G.z. e KSAK", nr. 21/78) aprovoj propozimin e BVI-së në fjalë.

Është vendosur si në dispozitivin e këtij aktvendimi.
U vendos pranë DREJTORISË PËR PUNËT PASURORE-JURIDIKE TË KK SE RAHOVECIT, nr. 164/85 prej 23.01.1986.

KËSHILLA JURIDIKE: pala e pakënaqur, kundër këtij aktvendimi mund të paraqes ankesë Drejtorisë Krahinore për punët pasurore-juridike në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Drejtorie, brenda 15 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit.

D r e j t o r i
Musa Raba, jurist i dipl.

Drejtoria për punët pasurore-juridike e Kuvendit të komunës së Rahovecit, duke vendosur sipas kërkesës së BVI-së për kulturë në Rahovec, në bazë të nenit 14. dhe 15. të Ligjit mbi eksproprijimin, („Gazeta zyrtare e KSAK“, nr. 21/78) dhe të nenit 202. të LPPA bie

AK T V E N D I M

I APROVOHET propozimi për eksproprijim me kompensim, në favor të BVI-së për kulturë të Rahovecit, dhe bartet në pronësinë shoqërore, në llogari të BVI-së së përmendur, parcela kadastrale nr. 1313/4, e evidentuar në fletën poseduese nr. 2559 KK Rahovec, në sipërfaqe prej 0.00,71 ha, në vend të quajtur Rruga „V. Bashkim, nën fshat“, me kulturë kopsht i kl. se 2. në emër të Januz Fejzullah Dulës nga Rahoveci, për nevojat e ndërtimit të „Shtëpisë së kulturës“ në Rahovec.

II Interesi i përgjithshëm është vërtetuar në bazë të aktvendimit të Kuvendit të komunës së Rahovecit, Ol nr. 463-1 prej 24.06.1985.

III Shfrytëzuesi i eksproprijimit, përfiton të drejtën e posedimit në paluajtshmërinë e eksproprijuar në ditën kur ky aktvendim merr formën e prerë, ndërsa kompensimi do të rregullohet në procedurën e veçantë, në vështirësi të nenit 28. dhe 29. të Ligjit mbi eksproprijim.

IV Shpenzimet e procedurës në emër të eksproprijimit i paguan shfrytëzuësi i eksproprijimit.

A r s y e t i m

BVI-a për kulturë në Rahovec, me kërkesën e vet nr. 73 të paraqitur më 11.10.1985, nga ky organ kërkon që të kryhet eksproprijimi i paluajtshmërisë së parcelës së shënuar në dispozitivin e këtij aktvendimi, për nevojat e ndërtimit të „Shtëpisë së kulturës“ në Rahovec.

Propozuesi, përveç aktvendimit mbi interesin e përgjithshëm, propozimit i aka bashkangjitur të gjitha provat e parapara në nenin 13. dhe 14. të Ligjit mbi eksproprijim, prej së cilës shifet se janë plotësuar kushtet për kryetjen e procedurës së eksproprijimit.

Ky organ, më 24.01.1986 të përmendurin e ka marrë një pyetje ku i njëjti ka deklaruar se nuk është kundër eksproprijimit, por se në emër të kompensimit si kundërvlerë të parcelës së tij kërkon që t'i jipet me ndërrim ndonjë parcelë, respektivisht truall adekuat parcelës së tij të përshtatshëm për ndërtimin e banesës individuale, ose t'i mundsohet punësimi, sepse ka më se dhjetë vjet që pret punësim dhe se ka evidencën në biro. Në fund i përmenduri thekson se është i pëlqim që të eksproprijohet parcela e tij, por, jo me kompensim në të holl por me ndërrim.

Kjo Drejtori, shqyrtoj lëndën me të gjitha shkresat, deklaratatë e të përmendurit dhe duke u bazuar në nenin 15. të Ligjit mbi eksproprijimin e paluajtshmërisë („G.z. e KSAK“, nr. 21/78) aprovoj propozimin e BVI-së për eksproprijim.

Është vendosur si në dispozitivin e këtij aktvendimi.

U vendos pranë DREJTORISË PËR PUNËT PASURORE-JURIDIKE TË KK SË RAHOVECIT, nr. 171/85 prej 24.01.1986.

KËSHILLA JURIDIKE: pala e pakënaqur, kundër këtij aktvendimi ka të drejtë ankese Drejtorisë Krahinore për punët pasurore-juridike në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Drejtorie në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit.

D r e j t o r i,
Musa Raba, jurist i dipl

Drejtoria për punët pasurore-juridike e Kuvendit të komunës së Rahovecit, duke vendosur sipas kërkesës së BVI-se për kulturë në Rahovec, në bazë të nenit 14. dhe 15. të Ligjit mbi eksproprijim, („Gazeta zyrtare e KSAK“, nr. 21/78) dhe të nenit 202 të LPPA bie

A K T V E N D I M

48 20 26

I APROVOHET propozimi për eksproprijim me kompensim, në favor të BVI-së për kulturë të Rahovecit, dhe bartet pronësia në llogari të BVI-së së përmendur dhe kështu bëhet pronësi shoqërore, parcela kadastrale nr. 1313/5, e evidentuar në fletën poseduese nr. 2559 KK Rahovec, në sipërfaqe prej 0.02,71 ha, në vend të quajtur Rruga „Vë Bashkim, Nën fshat“, me kulturë kopësht i klasës së 2. në emër të Xhemali Fejzullah Dulës nga Rahoveci, për nevojat e ndërtimit të „Shtëpisë së kulturës“ në Rahovec.

II Interesi i përgjithshëm është vërtetuar në bazë të aktvendimit të Kuvendit të komunës së Rahovecit, 01 nr. 463-1 prej 24. 06.1985.

III Shfrytëzuesi i ekspropriimit, përfiton të drejtën e posedimit në paluajtshmërinë e ekspropriuar në ditën kur ky aktvendim merr formën e prerë, ndërsa kompensimi do të rregullohet në procedurën e veçantë, në vështirim të nenit 28. dhe 29. të Ligjit mbi eksproprijim.

IV Shpenzimet e procedurës në emër të ekspropriimit i paguan shfrytëzuesi i ekspropriimit.

A r s y e t i m

BVI-a për kulturë në Rahovec, me kërkesën e vet të paraqitur nr. 73 prej 11.10.1985, nga ky Organ kërkon që të kryhet ekspropriimi i paluajtshmërisë së parcelës së shënuar në dispozitivin e këtij aktvendimi, për nevojat e ndërtimit të „Shtëpisë së kulturës“ në Rahovec.

Propozuesi, përveç aktvendimit mbi interesin e përgjithshëm, kërkesës i ka bashkangjitur të gjitha provat e parapara në nenin 13. dhe 14. të Ligjit mbi eksproprijim, prej se cilës shifet se janë plotësuar të gjitha kushtet për kryerjen e procedurës së ekspropriimit.

Ky Organ, më 26.12.1985 të përmendurin e ka marrë në pyetje ku i njëjti ka deklaruar se nuk është kundër ekspropriimit, por se në emër të kompensimit kërkon që të i ipet ndonjë truall adekuat parcelës së tijë dhe i përshtatshëm për ndërtimin e banesës, respektivisht shtëpisë individuale, pasi që momentalisht është shumë ngushtë, ku së truall tjetër nuk posedon. Në fund i përmenduri thekson se është i pëlqimit që në parcelën e tijë të bëhet ekspropriimi, por, me anë të ndërrimit, e jo me kompensim në të holla.

Kjo Drejtori, shqyrtoj lëndën me të gjitha shkresat, deklaraten e të përmendurit dhe duke u bazuar në nenin 15. të Ligjit mbi ekspropriimin e paluajtshmërisë („Gazeta zyrtare e KSAK“, nr. 21/78) aprovoj propozimin e BVI-së në fjalë.

Është vendosur si në dispozitivin e këtij aktvendimi.

U vendos pranë DREJTORISË PËR PUNËT PASURORE-JURIDIKE TË KK SË RAHOVECIT, nr. 112/85 prej 22.01.1986.

KËSHILLA JURIDIKE: pala e pakënaqur, kundër këtij aktvendimi mund të paraqes ankesë Drejtorisë Krahinore për punët pasurore-juridike në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Drejtorie, brenda 15 ditëve nga dita e pranimit.

D r e j t o r i,

Musa Raba, jurist i dipl.

